Qeveria e Kosovës
Vlada Kosova - Government of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë / Kancelarija za Dobro Upravljanje / Office on Good Goverance

RAPORT VJETOR PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË QEVERITARE PËR BASHKËPUNIM ME SHOQËRINË CIVILE 2019–2023 PËR VITIN 2019

Qershor 2020, Prishtinë

Lista e Shkurtesave

ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZQM/ZKM	Zyra për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MIE	Ministria e Integrimeve Evropiane
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MF	Ministria e Financave
MAP	Ministria e Administratës Publike
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
AT	Asistencë Teknike
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE 2
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3
1.1. SFONDI/HYRJE 6
2. PËRPARIMI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE 8
3. PËRPARIMI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE SPECIFIKE 14
1.RRITJA E PJESËMARRJES SË SHOQËRISË CIVILE NË POLITIKË BËRJE 14
2.PËRMIRËSIMI I KORNIZËS INSTITUCIONALE DHE LIGJORE PËR FINANCIM NË ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË PROGRAMEVE DHE PROJEKTEVE TË OSHC-VE ME INTERES PUBLIK 20
3. ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE DHE PROCEDURAVE PËR KONTRAKTIMIN E OSHC-VE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE 26
4. RRITJA DHE PROMOVIMI I VULLNETARIZMIT NË PROGRAMET ME INTERES PUBLIK 27
RREZIQET/SFIDAT DHE MASAT LEHTËSUESE 28
PËRFUNDIMET 29

1. Përmbledhje Ekzekutive

Një shoqëri civile e fuqishme mund të luaj një rol të rëndësishëm për t'u siguruar që parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, zbatohen në praktikë. Ajo, po ashtu, është një përbërës thelbësor i çdo demokracie. Duke i artikuluar brengat e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të) - të cilat nënkuptojnë të gjitha strukturat jo shtetërore, jo fitimprurëse në të cilat qytetarët organizohen për të ndjekur objektiva dhe ideale të përbashkëta - janë aktive në arenën publike dhe angazhohen në nisma që e nxisin pluralizmin dhe e përparojnë demokracinë pjesëmarrëse.[1]
Mbështetja e Komisionit Evropian për shoqërinë civile në kuadër të politikës së zgjerimit është e përqendruar në mundësimin dhe stimulimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe ajo pasqyrohet në dy qëllime kryesore: arritja e një mjedisi përkrahës për aktivitetet e shoqërisë civile dhe ndërtimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të qenë aktor të pavarur efektiv dhe llogaridhënës. Në mbështetjen e tij politike, Komisioni i ka nxitur shtetet në zgjerim që ta bëjnë legjislacionin më përkrahës për shoqërinë civile. Të gjitha këto përkushtime janë të pasqyruara në Udhëzimet për mbështetje nga BE-ja për shoqërinë civile në vendet në zgjerim 2014-2020.
Duke i pasur parasysh Udhëzimet e cekura më sipër Qeveria e Republikës së Kosovës në shkurt të vitit 2019 ka miratuar Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile për periudhën 2019-2023. Kjo Strategji i përkufizon objektivat strategjike dhe politikat që Qeveria e Kosovës synon që t'i arrijë në periudhën e ardhshme afatmesme në mënyrë që të përmirësohet mjedisi përkrahës për zhvillimin e shoqërisë civile dhe krijimin e parakushteve për një bashkëpunim më efektiv të organeve qeveritare me OSHC-të në proceset e reformave kyçe në vend. Një shoqëri civile aktive dhe e fuqizuar konsiderohet si një përbërës thelbësor i demokracive moderne pluraliste. Prandaj, zhvillimi i bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile në formësimin dhe zbatimin e politikave publike është thelbësor në zhvillimin e qeverisjes gjithë përfshirëse të orientuar nga qytetarët dhe respektimin e diversitetit në të gjitha aspektet e shoqërisë.[2]

Për të arritur këtë, janë vendosur katër objektiva strategjike për periudhën e zbatimit 2019-2023:

1. **Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë bërje; Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë-bërje;**
2. **Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OSHC-ve në interes publik;**
3. **Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike;**
4. **Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programe me interes publik.**

Mekanizmi kryesor që e koordinon procesin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile është Këshilli për bashkëpunimin Qeveri-Shoqëri Civile, i cili është themeluar në korrik të vitit 2019. Këshilli përbëhet nga 29 anëtarë, me një shumicë prej 15 përfaqësuesve nga OSHC-të dhe 14 përfaqësues nga institucionet shtetërore. Institucioni kryesor për mbështetjen e punës së Këshillit është Zyra për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM), e cila po ashtu, është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë.

[1] Guidelines for EU support to civil society in englargement countries 2014-2020.
[2] Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023

Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile zbatohet në linjë me Planin e Veprimit. Gjegjësisht, Strategjia i ka: **katër objektiva strategjike, 14 objektiva specifike, 33 tregues dhe 48 veprime të ndryshme.**

Në vitin 2019, niveli i zbatimit është si në vijim:

Objektivat Strategjike	**Veprimet e planifikuara për vitin 2019**	**Statusi i zbatimit të veprimeve në vitin 2019**
1. Pjesëmarrja e shoqërisë civile në bërjen e politikave	**9**	3- të zbatuara 6- në zbatim e sipër
2. Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OSHC-ve në interes publik	7	4- të zbatuara 2- në zbatim e sipër 1- e pa zbatuar
3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike;	**1**	1- e pa zbatuar
4. Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programe me interes publik.	/	/
Totali	**17**	**7- të zbatuara** **8- në zbatim e sipër** **2- të pa zbatuara**

Përparim domethënës është arritur në dy fusha: përmirësimi i standardeve për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në bërjen e politikave dhe krijimi i një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financim publik.
Së pari, zhvillimi i standardeve dhe praktikave për rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit është një proces që ka filluar në vitin 2016 me miratimin e Rregullores për Standardet Minimale për Konsultime Publike (Nr. 05/2016), dhe ka vazhduar përgjatë viteve, me zhvillimin dhe përmirësimin e Platformës Qendrore Online për Konsultime Publike, me krijimin e mekanizmave koordinues në secilën ministri, ndërtimin e kapaciteteve të koordinatorëve për konsultime publike dhe nëpunësve tjerë civil si dhe me promovimin publik dhe ngritjen e vetëdijes për dobitë e një platforme të tillë për OSHC-të dhe qytetarët në përgjithësi. Platforma, ofron mundësi që hisedarët nga shoqëria civile dhe publiku i gjerë të kenë mundësi të regjistrohen, nëse janë të interesuar që të japin kontributin e tyre në hartimin e politikave apo ligjeve të ndryshme. Për më tepër, ky përparim

konfirmohet edhe nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare, si Banka Botërore përmes projektit të tyre "Global Indicators of Regulatory Governance" (Treguesit Global të Qeverisjes Rregulluese) i cili i përfshinë 187 shtete të botës, ku Kosova është radhitur e para ndër shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe e njëzet e katërta në mesin e të gjitha shteteve të përfshira.

Së dyti, gjatë tri viteve të fundit, Qeveria e Republikës së Kosovës i ka vendosur praktikat, standardet dhe kriteret për shpërndarjen e fondeve publike për shoqërinë civile me miratimin e Rregullores për *kriteret, standardet dhe procedurat bazike* për financimin publik të OSHC-ve në vitin 2017. Nga të dhënat e mbledhura nga institucionet shtetërore, ueb faqet e institucioneve shtetërore dhe puna e kryer drejtpërdrejt nga Zyra për Qeverisje të Mirë, për ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore, ka përparim të dukshëm në zbatimin e rregullores për financimin publik të organizatave të shoqërisë civile.
Përparimi në fushën e përfshirjes së qytetarëve dhe OSHC-ve në bërjen e politikave dhe përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së sistemit të financimit publik është baza kryesore për çdo ndërtim të mëtejmë tejet të rëndësishëm të besimit të ndërsjellë në mes të institucioneve shtetërore dhe OSHC-ve.

Pas një viti të zbatimit të Strategjisë, mund të arrihet në përfundimin se ky përkushtimi i Qeverisë për të mbështetur zhvillimin e shoqërisë civile duhet të vazhdojë dhe përparojë në të ardhmen. Mirëpo, edhe çështje dhe sfida të tjera të rëndësishme në fushat e ndryshme që kanë të bëjnë me OSHC-të duhet të ngritën dhe zbatohen me qëllim të pasjes së një shoqërie civile të pavarur, transparente dhe pro aktive. Qeveria duhet të vazhdojë të trajtojë shoqërinë civile si shtyllë kryesore dhe partner të besueshëm drejt proceseve demokratike dhe integrimit të vendit në BE.

Buxheti total i planifikuar është 235.500 EUR (72% nga Buxheti Shtetëror dhe 28% nga donatorët potencial). Duhet theksuar se shumica e aktiviteteve gjatë vitit 2019 janë zbatuar nga ZQM/ZKM me mbështetjen e Projektit të AT të BE-së.

1.1. Sfondi/Hyrje

Strategjia për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile për periudhën 2019-2023 është miratuar nga Qeveria e Kosovës në shkurt të vitit 2019. Kjo Strategji i përkufizon objektivat strategjike dhe politikat që Qeveria e Kosovës synon që t'i arrijë në periudhën e ardhshme afatmesme në mënyrë që të përmirësohet mjedisi përkrahës për zhvillimin e shoqërisë civile dhe krijimin e parakushteve për një bashkëpunim më efektiv të organeve qeveritare me OSHC-të në proceset e reformave kyçe në vend. Një shoqëri civile aktive dhe e fuqizuar konsiderohet si një përbërës thelbësor i demokracive moderne pluraliste. Prandaj, zhvillimi i bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile në formësimin dhe zbatimin e politikave publike është thelbësor në zhvillimin e qeverisjes përfshirëse të orientuar nga qytetarët dhe respektimin e diversitetit në të gjitha aspektet e shoqërisë.[3]

Vizioni dhe fokusi strategjik, në mes të tjerave, është udhëhequr nga orientimi i Komisionit Evropian për krijimin e një mjedisi përkrahës ligjor, institucional dhe financiar për shoqërinë civile, i cili është jetik, dhe se qeveritë duhet të sigurojnë pjesëmarrjen aktive të OSHC-ve në proceset e reformave dhe të politikë bërjes, përmes krijimit të një dialogu përfshirës të strukturuar. Gjegjësisht, Strategjia e BE-së për 'Një perspektivë të besueshme të zgjerimit për një angazhim të përforcuar të BE-së në Ballkanin Perëndimor' e shkurtit 2018[4] thekson se Udhëzimet për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit 2014-2020[5] të miratuara nga DGj për Zgjerim e Komisionit Evropian e theksojnë rëndësinë e vendosjes së objektivave të qarta, rezultateve dhe treguesve për monitorimin e përparimit të qeverive në këtë fushë. Këto elemente janë bërë pjesë e rëndësishme e kritereve politike dhe ato pasqyrohen rregullisht në raportet vjetore për përparimin e Kosovës në procesin e integrimit në BE në përputhje me pikën 4 të preambulës së MSA-së, ku zhvillimi i shoqërisë civile dhe demokratizimi janë të përfshira si elementet e para për të cilat palët (duke e përfshirë edhe Republikën e Kosovës) përkushtohen për të kontribuuar në stabilizimin politik, ekonomik dhe institucional të Kosovës dhe rajonit[6].

Strategjia është përgatitur nga ekipi i punës i krijuar nga Zyra e Kryeministrit, me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm dhe i cili përbëhej nga përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile, me mbështetje profesionale nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe Projekti i Asistencës Teknike i BE-së "Mbështetje për Zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile". Ky ekip ka qenë shumë pro aktiv në plotësimin dhe konfirmimin e vlerësimit të Strategjisë së mëparshme, duke përcaktuar fushat me prioritet dhe përkufizimin e misionit/vizionit të Strategjisë për periudhën 2019-2023. Ekipi u udhëhoq nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe u bashkë kryesua nga Platforma CiviKos, dhe ai përbëhej nga përfaqësues të ministrive të linjës dhe OSHC-të.

Për më tepër, objektivat e Strategjisë për periudhën 2019-2023 janë vendosur në bazë të konsultimeve me shoqërinë civile, duke i marrë parasysh rezultatet e vlerësimit të strategjisë së mëparshme, si dhe prioritetet e gjera të vendosura në dokumentet përkatëse të Bashkimit Evropian. Në këtë mënyrë, u sigurua plotësimi dhe vazhdimësia e objektivave dhe masave të planifikuara në dokumentet e tjera strategjike përkatëse të qeverisë, gjegjësisht Programin e

---

[3] Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023

[4] Komunikata e Komisionit Evropian „A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans", COM (2018) 65 final, 6 shkurt 2018.

[5] Komisioni Evropian, „DGj për Zgjerim: Guidelines for EU support to civil society in englargement countries 2014-2020," Nëntor 2013, fq. 4.

[6] Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023

Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, Strategjinë Zhvillimore Kombëtare 2016-2021, Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2017-2021 dhe Strategjinë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Bashkërendimit të Politikave në Kosovë 2017-2021.

Është shumë me rëndësi që të theksohet se është krijuar struktura e përgjithshme për bashkëpunimin e Qeverisë me Shoqërinë Civile. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ishte pro aktive në të gjitha segmentet e koordinimit dhe zbatimit të objektivave strategjike, e po ashtu është krijuar edhe Këshilli për Bashkëpunim në mes të Qeverisë dhe Shoqërisë Civile. Pasja e strukturës përkatëse institucionale është faktor kyç për zbatimin me sukses të Strategjisë, posaçërisht kur institucionet janë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e përparimit të qëllimeve strategjike.
Këshilli për Bashkëpunimin e Qeverisë me Shoqërinë Civile u krijua në prill të vitit 2019, me Vendimin e Qeverisë 05/96. Ai është themeluar si kryesor i përhershëm këshillues për Qeverinë i cili do të koordinoj të gjithë procesin e bashkëpunimit të Qeverisë me Shoqërinë Civile, për të promovuar dhe mbështetur fuqizimin e sektorit civil dhe për të siguruar bashkëpunimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim.
Seanca e tij e parë konstituive u mbajt më 17 korrik 2019. Këshilli përbëhet nga 29 anëtarë: 15 përfaqësues të OSHC-ve dhe 14 shërbyes civil nga ministritë përkatëse. Gjatë periudhës së raportimit Këshilli i ka mbajtur një punëtori dhe dy seanca të Këshillit. Gjithashtu, ai i ka miratuar Rregullat për Punës, ka përgatitur Planin e tij Vjetor të Punës për periudhën janar-dhjetor 2020. Janë krijuar katër ekipe punuese që do ta përkrahin punës e tij dhe për secilin ekip janë mbajtur takime pune veç e veç, janë hartuar rregullat e punës për ekipet dhe janë përzgjedhur koordinatoret e secili ekip të punës. Gjatë tërë këtyre proceseve dhe përgatitjes së dokumenteve Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit e ka koordinuar punën dhe bashkë me CiviKos-in, koordinatorët e ekipeve dhe me mbështetje të AT e BE-së kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetje të veprimeve të Këshillit.

Më poshtë në këtë raport, është paraqitur përparimi i zbatimit të Strategjisë/Planit të Veprimit për vitin 2019. Raporti e përcjellë Strategjinë dhe Planin e saj të Veprimit, prandaj është i strukturuar sipas:

- objektivave strategjike;
- objektivave specifike dhe
- aktiviteteve.

Janë përdorur të gjitha të dhënat në dispozicion nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, ministritë, komunat dhe institucionet e tjera të mbledhura përmes ueb faqeve dhe komunikimeve të drejtpërdrejta me e-mail.

2. Përparimi në zbatimin e objektivave strategjike

Strategjia për Bashkëpunimin e Qeverisë me Shoqërinë Civile i ka katër objektiva me prioritet:

1. **Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë bërje;**

2. **Përmirësimi i kornizës institucionale për financimin e qëndrueshmërisë së programeve dhe projekteve të OSHC-ve në interes publik;**
3. **Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OShC-ve për ofrimin e shërbimeve publike;**
4. **Rritja dhe promovimi i vullnetarizmit në programe me interes publik.**

Këto objektiva janë plotësim i objektivave me prioritet të përcaktuara në Udhëzimet për mbështetje të BE-së për Shoqërinë Civile në Vendet në Zgjerim 2014-2020, të zbatuara nga Komisioni Evropian. Ato të gjitha adresojnë reforma shumë komplekse dhe të ndërlidhura në politika të cilat së bashku mund të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi më shumë përkrahës për shoqërinë civile në Kosovë.
Përgjegjësia për koordinimin e monitorimit dhe raportimit të Strategjisë dhe planit të veprimit i takon ZQM/ZKM-së por, përfshirja e të gjitha institucioneve përgjegjëse për aktivitetet e tyre përkatëse është jetike si për zbatimin ashtu edhe për monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve.

Siç është paraqitur më sipër, arritja kryesore është vërejtur në zbatimin e Objektivit Strategjik 1 dhe Objektivit Strategjik 2.
Pothuajse asnjë aktivitet nuk është planifikuar për vitin 2019 në kuadër të Objektivit Strategjik 3 dhe Objektivit Strategjik 4.

Objektivi strategjik 1: Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në bërjen e politikave

Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë, në këtë objektiv strategjik priten dy **të arritura** kryesore:

- Përmirësimi i përfshirjes së OSHC-ve në fazat fillestare të hartimit të legjislacionit dhe politikave;
- Rritja e kontributit të OSHC-ve në bërjen e politikave.

Treguesi i synuar për rezultatin e parë është:

- Numri i OSHC-ve të përfshira në grupet punuese për hartimin e politikave të reja dhe fazave të hershme të zhvillimit të legjislacionit, me më së paku 50 OSHC kurse synimi është 150 OSHC.

Po ashtu, sipas të dhënave në dispozicion, krahas konsultimeve online, 103 dokumente (apo 37% i numrit total të dokumenteve të konsultuara) u konsultuan përmes punëtorive, përderisa 99 dokumente apo 36% u konsultuan përmes postës elektronike. Krahas kësaj, 35 dokumente apo 12,6% u konsultuan përmes takimeve publike, 24 dokumente apo 8,6% u konsultuan në takime të drejtpërdrejta dhe 21 dokumente apo 7,6% u konsultuan përmes takimeve të hisedarëve. Pjesëmarrësit në këto takime ishin kryesisht përfaqësues të OSHC-ve.

Numri i dokumenteve të cilat i janë nënshtruar konsultimit më publikun është 100%.

Plotësimi i standardeve minimale të procesit të konsultimeve publike shprehur në përqindje gjatë vitit 2019 është 67%. Shkalla e plotësimit të standardeve minimale i paraqitur në këtë raport bazohet në informatat e dërguara nga ana e koordinatorëve të ministrive, por edhe nga platforma elektronike për konsultime publike. Vlerësohet se nga numri i përgjithshëm i dokumenteve të konsultuara (274 dokumente), standardet minimale të parapara me rregullore i plotësojnë gjithsej 183 apo 67% ndërsa numri i dokumenteve të cilat nuk kanë plotësuar të gjitha standardet minimale janë gjithsejte 91 dokumente apo 33% (figura 6). Ndër standardet që në shumicën e dokumenteve nuk përmbushen është mungesa e publikimit të raportit të konsultimit. Gjithashtu shumë dokumente nuk e kanë të publikuar dokumentin e konsultimit apo nuk e respektojnë kohëzgjatjen e konsultimit prej 15 ditë pune ashtu siç kërkohet shprehimisht me rregullore.

Treguesi i dytë në këtë nivel ndërlidhet me:

- Numrin e OSHC-ve që kontribuojnë në konsultimet e hapura publike për draft politikat, ku deri në fund të vitit 2021 synohet përfshirja e 350 OSHC-ve[7].

Numri i pjesëmarrësve në procesin e konsultimeve publike e ka tejkaluar dyfishin në krahasim me vitin 2018. Është raportuar se 3577 pjesëmarrës kanë marrë pjesë në procesin e konsultimeve publike, të cilët i kanë bërë 1339 komente qoftë përmes takimeve, grupeve punuese apo edhe me shkrim. Vlerësohet se 688 apo 61% e tyre janë pranuar nga institucionet hartuese, 97 apo 7,2% u pranuan pjesërisht përderisa 53 komente apo 4,50% u refuzuan.

Për më tepër, në vitin 2019, ZQM/ZKM-ja me mbështetjen e Projektit të Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian u fokusua dhe arriti **përparim në disa drejtime** si[8]:

• Rritja e numrit të dokumenteve të konsultuara në vitin 2019 në 276 kundrejt 228 në vitin 2018. Nga ky total, gati 100% ose të gjitha këto dokumente i janë nënshtruar konsultimeve publike. Nga ky numër i përgjithshëm, konsultimit publik i janë nënshtruar 100% apo të gjitha këto dokumente. Përmes platformës për konsultimet me publikun i janë nënshtruar 272 dokumente ndërsa 2 prej tyre dokumente janë konsultuar jashtë platformës. Nga ky numër i përgjithshëm janë: 15 koncept dokumente, 31 projekt ligje, 77 projekt rregullore, 129 projekt udhëzime administrative, 6 strategji, 5 programe, 7 plane të veprimit dhe 8 dokumente tjera.

• Rritja e përmbushjes së standardeve të procesit të konsultimit me 67% në vitin 2019, që është më shumë se 56% në vitin 2018 dhe 52% në vitin 2017.

• Fuqizimi i bashkëpunimit të koordinatorëve në ministri me ZQM-në dhe nëpunësit tjerë civil përgjegjës për konsultimet publike.

• Mbajtja e trajnimeve, punëtorive dhe trajnimeve në vendin e punës në nivel qendror dhe lokal për të rritur kapacitetet e shërbyesve civil përgjegjës.

[7] Minimumi për këtë tregues është 100 OSHC

[8] Raporti Vjetor për vitin 2019 për konsultimet publike në Republikën e Kosovës

• Platforma elektronike për konsultimet publike është përmirësuar me kategori të reja të statistikave, të cilat mund të gjenerohen në mënyrë automatike dhe platformës i është shtuar është moduli i konsultimeve në nivel komunal.

Në përgjithësi, përparimi i arritur në zhvillimin e standardeve dhe praktikave për të rritur pjesëmarrjen e shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe legjislacionit është domethënës. Është një proces që ka filluar në vitin 2016 me miratimin e Rregullores për Standardet Minimale për Konsultime Publike (Nr. 05/2016), dhe ka vazhduar përgjatë viteve, me përmirësimin e Platformës Qendrore Online për Konsultime Publike, me ndërtimin e kapaciteteve të koordinatorëve për konsultime publike dhe të shërbyesve të tjerë civil, si dhe me promovimin publik dhe ngritjen e vetëdijes për dobitë e një platforme të tillë për OSHC-të dhe qytetarët në përgjithësi. Platforma, ofron mundësi që hisedarët nga shoqëria civile dhe publiku i gjerë të kenë mundësi të regjistrohen, nëse janë të interesuar që të japin kontributin e tyre në hartimin e politikave apo ligjeve të ndryshme.

Ky përparim vjen falë punës së vazhdueshme dhe përkushtimit të Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit, koordinatorëve të konsultimeve publike në të gjitha ministritë e linjës dhe mbështetjen e vazhdueshme të projektit të AT-së të BE-së. Për më tepër, ky përparim konfirmohet edhe nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare, si Banka Botërore përmes projektit të tyre "Global Indicators of Regulatory Governance" (Treguesit Global të Qeverisjes Rregulluese) i cili i përfshinë 187 shtete të botës, ku Kosova është radhitur e para ndër shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe e njëzet e katërta në mesin e të gjitha shteteve të përfshira. Në krahasim me vitin 2016 kur Kosova mori 4,60 pikë sipas indeksit të njëjtë, përparime janë shënuar në procesin e bërjes së politikave duke e rritur nivelin e transparencës gjatë hartimit të politikave, përfshirjes më të madhe të hisedarëve dhe publikut në këtë proces dhe vlerësimin e ndikimit që këto politika i kanë në jetën e qytetarëve. Në fushën e konsultimeve, Kosova i përmbush të gjitha kriteret sipas të cilave është bërë vlerësimi[9].

Po ashtu, është miratuar edhe udhëzimi për krijimin e rregullave dhe standardeve për konsultime publike në nivel lokal. Me këtë rregullore, Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, i jep udhëzimet bazë për komunat se si të krijojnë politika në bazë të nevojave dhe mendimeve të qytetarëve. Në këtë linjë, të gjitha aspektet dhe përvojat pozitive nga niveli kombëtar duhet të transferohen tek njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Krahas përparimit të madh të arritur në këtë objektiv strategjik, disa **sfida** nga viti 2019 duhet të adresohen në të ardhmen[10]:

- Shkalla e plotësimit të standardeve megjithëse ka pasur rritje në 5% prapë paraqet sfidë, e sidomos hartimi dhe publikimi i raportit të konsultimit është një nga faktorët të cilët nuk përcjellët në nivelin e duhur nga shumë ministri.
- Ndërrimi i koordinatorëve është paraqitur si sfidë edhe gjatë vitit 2019.
- Koordinatorët përmes anketës kanë përmendur një numër të sfidave, sidomos mungesa e palëve të interesit për të dhënë komente, pastaj mungesa e koordinimit të procesit të konsultimeve brenda institucioneve për kompletimin e procesit të konsultimit.

[9] Raporti Vjetor për vitin 2018 për konsultimet publike në Republikën e Kosovës
[10] Raporti Vjetor për vitin 2019 për konsultimet publike në Republikën e Kosovës

- Nuk bëhet në të gjitha rastet udhëheqja e konsultimeve nga ana e departamenteve që janë përgjegjëse për hartimin e dokumenteve përkatëse por nga departamentet Ligjore ose DIEKP-të.
- Rritja e numrit të komenteve të palëve të interesit në proces të konsultimit paraqet sfidë. Kjo mund të bëhet përveç tjerash edhe përmes përdorimit të metodave tjera përveç platformës elektronike për konsultimet publike.
- Avancimit të mëtejshëm të platformës elektronike për gjenerimin e informatave si, pjesëmarrjes dhe komenteve të ofruara edhe jashtë platformës elektronike.
- Informatat e ofruara nga ana e koordinatorëve gjatë procesit të raportimit, shpesh nuk përputhen me ato që gjenerohen në platformë. Përveç kësaj ato informata janë edhe jo të plota.
- Takimet fillestare Publike, të obligueshme sipas dispozitës 13.3.1 të Rregullores në masë të madhe nuk mbahen nga organet konsultuese me palë të jashtme të interesuara;
- Raportet finale të konsultimeve në të shumtën e rasteve nuk publikohen me kohë, respektivisht menjëherë pas përfundimit të proceseve të konsultimit dhe përcjelljes së dokumenti për aprovim.

Objektivi strategjik 2: Përmirësimi i kornizës rregulluese dhe institucionale për qëndrueshmëri financiare të programeve dhe projekteve të OSHC-ve në interes të publikut

Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë, në këtë objektiv strategjik pritet një **rezultat**:

- Thirrje publike në pajtim të plotë me Rregulloren për Kriteret, Standardet dhe Procedurat për Financim Publik të OSHC-ve.

Treguesi i synuar për rezultatin e parë është:

- Përqindja e institucioneve që bëjnë thirrje publike për financimin e OSHC-ve në përputhje me Rregulloren për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OSHC-ve. Synimi i përkohshëm është 75% e të gjitha institucioneve të zhvillojnë thirrje publike për financimin e OSHC-ve në linjë me Rregulloren.

Në vitin 2019, 52 % e ministrive dhe komunave kanë raportuar sipas rregullores dhe kanë publikuar thirrje të hapura për OSHC-të në përputhje me Rregulloren. Është përmirësuar dukshëm në krahasim me vitin 2018.

Krahas kësaj, nga të dhënat e mbledhura nga institucionet shtetërore, ueb faqet e institucioneve shtetërore dhe puna e kryer drejtpërdrejt nga ZQM-ja, për ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore, ka përparim të dukshëm në zbatimin e rregullores për financimin publik të organizatave të shoqërisë civile. Rritja është e dukshme në disa aspekte. Të dhënat tregojnë se mbështetja financiare publike që iu dhënë OSHC-ve nga institucionet publike, duke i përfshirë institucionet qendrore (Kuvendi, Presidenca, Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë), agjencitë e pavarura dhe komunat për vitin 2019 është pothuajse 21 milionë euro.

Në krahasim me dy vite më parë, ka një rritje prej 5 milionë euro, ndonëse ka një rënie të lehtë prej rreth 1,5 milionë euro në krahasim me vitin 2018, e cila vjen për shkak të uljes së mbështetjes financiare për OSHC-të në nivel lokal (komunal).
Në nivel të ministrive, shuma totale është 14 milionë euro (rritje prej pothuajse 300.000 euro në krahasim me vitin 2018), dhe në nivel lokal është 6,5 milionë (rënie prej 1,9 milionë në krahasim me vitin 2018). Po ashtu, agjencitë shtetërore i kanë dhënë rreth 315.000 euro. Në total, 1.308 OSHC kanë pranuar mbështetje shtetërore nga burime kombëtare dhe lokale, apo 548 OSHC kanë pranuar fonde nga ministritë dhe institucionet e tjera në nivel kombëtar, dhe 780 organizata janë financuar nga komunat.

Sidoqoftë, ka ende institucione shtetërore që nuk shpallin thirrje publike dhe nuk ofrojnë mbështetje financiare publike për OSHC-të siç e kërkon Rregullorja. Ndonëse Rregullorja ka kërkesa të qarta, disa organizata buxhetore, ndonëse kanë shpallur thirrje publike, ato nuk kanë qenë tërësisht në përputhje me kërkesat e Rregullores.[11]

Në vitin 2019, u përgatit, u publikua dhe iu prezantua publikut të gjerë Raporti vjetor për financimin publik. Raporti vjetor e thekson nevojën për përmirësimin e kapaciteteve institucionale për të qenë në pajtim me kërkesat e reja, duke cekur se disa ministri dhe komuna ende nuk janë gati për t'i përmbushur obligimet e tyre sipas Rregullores, dhe se ende ka mungesë të kapaciteteve teknike për ekzekutimin efektiv të buxhetit të ndarë në pajtim me rregullat dhe procedurat e vendosura.

Për më tepër, për disa komuna janë organizuar seanca trajnuese në vendin e punës shtesë mbi standardet e financimit publik të OSHC-ve, si dhe është filluar përditësimi i Doracakut për Zbatimin e Rregullores mbi Kriteret për Financimin Publik të OJQ-ve, në bazë të mësimeve të nxjerra në zbatimin e thirrjeve për propozime nga ministritë dhe komunat gjatë dy viteve të fundit.

Nga një analizë e përgjithshme e këtyre institucioneve shihet se thirrjet publike janë avancuar gjatë vitit 2019, duke shënuar një progres të pakontestueshëm në përgatitjen e thirrjeve publike, publikimin e tyre dhe përzgjedhjen e aplikantëve.

Objektivi strategjik 3: Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve publike.

Sipas Planit të Veprimit të Strategjisë, në këtë objektiv strategjik pritet një **rezultat**:

- Rritja e numrit të OSHC-ve të kontraktuara në ofrimin e shërbimeve publike përmes thirrjeve/tenderëve të hapur publik.

Treguesi i synuar për këtë rezultat është:

[11] Raporti vjetor për mbështetjen financiare publike për organizatat jo-qeveritare në Republikën e Kosovës për vitin 2018.

- Numri i OSHC-ve të kontraktuara në ofrimin e shërbimeve publike përmes thirrjeve/tenderëve të hapur publik.

Prurja e praktikave dhe procedurave më të mira për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike mbesin një sfidë e madhe për vitin 2019. Shumica e aktiviteteve në Strategji janë të parapara për vitin 2020.

Objektivi strategjik 4: Rritja e vullnetarizmit në programet me interes publik

Të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me objektivin e katërt janë të planifikuara që të fillojnë në vitin 2020. Gjithsesi, disa aktivitete përgatitore kanë filluar në vitin 2019, me fokusin kryesor në përmirësimin e legjislacionit për vullnetarizmin. Rritja e vullnetarizmit në programet me interes publik, përbëhet nga gjashtë aktivitete, kryesisht të planifikuara për zbatim në vitin 2020-2021, mirëpo edhe përkundër kësaj Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit kanë punuar dhe kanë zhvilluar draftin e koncept dokumentit për vullnetarizëm. ZQM/ZKM me përkrahjen e ekipit të punës dhe në bashkëpunim me OJQ LENS janë në proces të finalizimit të këtij drafti. Për zhvillimin e këtij dokumenti është bërë edhe ndarja e praktikat rajonale të rregullimit të vullnetarizmit dhe definimi i vlerave të vullnetarizmit në kontekstin e Kosovës. Në përmbledhjen e draft koncept dokumentit paraqiten opsionet për hartimin dhe adaptimin e një politike nga Qeveria e Kosovës për të krijuar një kornizë ligjore dhe institucionale të përshtatshme dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin e vullnetarizmit në vend. Ashtu si edhe është raportuar iniciativa për zhvillimin dhe rregullimin e vullnetarizmit në Kosovë vjen si prioritet i paraparë në Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2019-2023) dhe Planit të Veprimit për implementimin e Strategjisë .

3. Përparimi në zbatimin e Objektivave Specifike

1.Rritja e pjesëmarrjes së Shoqërisë Civile në politikë bërje

Pjesëmarrja e qytetarëve në bërjen e politikave është një prej arritjeve kyçe që janë bërë gjatë tri viteve të fundit. Institucionet janë vetëdijesuar se opinioni publik për draft legjislacionin do të kontribuojë me rregullime që iu përshtaten shumicës së nevojave të qytetarëve, të cilat i marrin parasysh mundësitë e barabarta dhe kontribuojnë në sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë. Është me rëndësi që Qeveria e ka vullnetin që të transferojë tërë përvojat pozitive nga niveli qendror në atë lokal.
Kapacitetet e përmirësuara të institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile për procese të hapura për konsultime publike është fokusi i këtij objektivi. Për më tepër, ngritja e vetëdijes se qytetarëve për konsultimet publike duhet të kontribuojë në rritjen e nivelit të përgjithshëm të të kuptuarit dhe praktikuarit të pjesëmarrjes qytetare në bërjen e politikave.
Objektivi i parë strategjik (i përgjithshëm): Rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në politikë bërje i ka tri objektiva specifike:

#	Objektivi i Përgjithshëm	Objektivi Specifik

1	Rritja e pjesëmarrjes së Shoqërisë Civile në politikë bërje	1.1	Përmirësimi i kapaciteteve të Autoriteteve Shtetërore për përfshirjen e OSHC-ve në politikë bërje
		1.2	Rritja e vetëdijes së qytetarëve dhe shoqërisë civile për konsultimet publike
		1.3	Përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të kontribuuar në procesin e konsultimeve publike

Për Objektivin Specifik 1.1 janë paraparë dy rezultate:

Rezultati i Parë: Kapaciteti i zyrtarëve të institucioneve publike për zbatimin e standardeve minimale për konsultime publike është zhvilluar dhe përmirësuar
Treguesi i Dytë: Numri i stafit përkatës së ZKM-së, ministrive të linjës të trajnuar në zbatimin e standardeve minimale për konsultime publike.

- Synimi i përkohshëm për këtë tregues është 100 shërbyes civil të cilët do të trajnohen për zbatimin e standardeve minimale për konsultime publike. Sipas të dhënave në dispozicion, ky numër është duke **përparuar**.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në funksion të zbatimit të Rregullores për Standardet Minimale në procesin e Konsultimeve me Publikun me mbështetje të Projektit të Asistencës Teknike të BE-së, ka organizuar trajnime e punëtori me nëpunës civile dhe koordinatorët përgjegjës në ministri. Ministrive ju është ofruar mbështetje e vazhdueshme nga ana e Zyrës për Qeverisje të Mirë përmes informatave të përditshme dhe përgjigje dhe sqarime siç është kërkuar nga ministritë. Trajnime të vendin e punë i është ofruar Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Seanca e trajnimit në vendin e punës për këtë ministri është ofruar me datë: 26 nëntor 2019 dhe në të cilën kanë marrë pjesë 13 pjesëmarrës nga menaxhmenti dhe stafi i ministrisë. Përveç mbështetjes për zhvillim të konsultimeve Ministrive ju është ofruar mbështetje në hartimin apo mbledhjen e kontributeve për hartimin e Raportit Vjetor të Konsultimeve për vitin 2019. Seanca janë mbajtur me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa mbështetje gjithashtu është ofruar për Ministrinë e Drejtësisë. Në vitin 2019 Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bashkë me IKAP-in, ka zhvilluar trajnimin në fushën Administratës dhe Legjislacion më temën " Procesin i konsultimit me publikun " me dy grupe të pjesëmarrësve. Grupi i parë me 02-03 prill 2019, dhe grupi i dytë me 15 -16 prill 2019. Qëllimi i organizimit të trajnimeve ka pasur target zyrtarët përgjegjëse për hartimin e legjislacionit dhe politikave në ministritë e linjës. Numri i zyrtarëve që kanë qenë pjesë në këto dy raunde trajnimi ku kanë qenë: 32 pjesëmarrës për grupin e parë dhe 24 për grupin e dytë. Gjithashtu ZQM/ZKM bashkë me IKAP-in dhe MAPL me 09 dhe 10 shtator 2019 kanë realizuar rundin tjeter të trajnimeve - Procesi i konsultimit publik në nivel lokal, ku pjesë e tij kanë qenë pesë komuna me nga 6 zyrtarë publik. Duke ndjekur këto nevoja, duke u bazuar në suksesin e aktiviteteve të mëparshme të trajnimeve, si dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i standardeve minimale për konsultime publike gjatë viteve të fundit ZQM.ZKM, në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administrata Publike, me mbështetjen e projektit të BE-së "Mbështetje për Zbatimin e Strategjisë së Qeverisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile" kanë planifikuar dhe e kanë ofruar Programin e trajnimit të trajnerëve (ToT), program që synon të krijojë një grup trajnues që në të ardhmen do të jenë në gjendje të ofrojë për konsultimet publike për institucionet. Në këtë mënyrë, do të sigurohet qëndrueshmëria e aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve të ndërmarra vitet e kaluara me

mbështetjen e projektit të asistencës teknike të BE-së. Për më tepër, zbatimi i programit ToT do të japë shtysë shtesë në përmbushjen e indikatorëve të Ndihmës Sektoriale Buxhetore për administratën publike në Kosovë. Gjatë vitit 2019, janë kryer të gjitha përgatitjet për finalizimin e procesit të Trajnimit të Trajnerëve, si hartimi i programit të trajnimit, përgatitja e thirrjes publike, finalizimi i thirrjes publike dhe publikimi i saj. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve është përfunduar ndërsa trajnimi po ashtu është realizuar gjatë muajit mars 2020.

Rezultati i Dytë: Zbatimi efikas i standardeve minimale për konsultime publike në 100%.
Treguesi i Dytë: Niveli i përputhjes[12] së hartimit të politikave dhe legjislacionit të jetë në linjë të plotë me Standardet Minimale për konsultimet publike deri në vitin 2021(bazuar në vendimin e qeverisë për mbështetjen e drejtëpërdrejt buxhetore të RAP).

- Synimi i përkohshëm për këtë tregues është që deri në vitin 2021, 100% e organeve qeveritare të jenë në përputhje me standardet minimale për konsultime. Rezultatet nga raporti vjetor për konsultime publike për vitin 2019 tregon përparim për shkak se 156 dokumente, ose 57% e dokumenteve të konsultuara, i kanë plotësuar standardet minimale të parapara me Rregullore.

Për Objektivin Specifik 1.2 janë paraparë dy rezultate:

Rezultati i Parë: 500 OJQ janë abonuar në platformën online
Treguesi i 1-rë: rritja e numrit të organizatave të shoqërisë civile të regjistruara në Platformën Online

- Synimi i përkohshëm është shtimi me 50% (në krahasim me numrin fillestar prej 151 OSHC-ve) i OSHC-ve që duhet të regjistrohen në Platformën Online. Në fund të vitit 2019, 178 OSHC ishin të abonuara në platformën online, gjë që tregon **përparim në zbatim**.

Rezultati i Dytë: 5000 komente në platformën online
Treguesi i Dytë: Shtimi i numrit të qytetarëve individual që japin komente në Platformën Online

- Synimi i përkohshëm është rritje me 50% në krahasim me numrin fillestar prej 1119 komenteve. Në vitin 2019, numri i komenteve të dhëna ishte 1339, të cilat janë dhënë nga 3577 pjesëmarrës, gjë që tregon **përparim në zbatim**.

Për Objektivin Specifik 1.3 është paraparë një rezultat:

Rezultati: Njohuri të përmirësuara të OSHC-ve për ciklin e politikë bërjes dhe shkathtësi të përmirësuara për shfrytëzimin e platformës online dhe për të kontribuuar në procesin e konsultimeve publike
Treguesi: Numri i OSHC-ve të trajnuara në bërjen e politikave dhe përdorimin e Rregullores dhe Platformës Online

- Synimi i përkohshëm është 200 OSHC të trajnuara. Duke qenë se të gjitha aktivitetet për këtë objektiv specifik janë planifikuar që të zbatohen në vitet 2020 dhe 2021, **përparimi do të matet në raportin e ardhshëm vjetor**.

Zbatimi i Aktiviteteve (Veprimeve)

Në total, 13 veprime janë planifikuar në Planin e Veprimit, 9 prej të cilave janë për vitin 2019.

Në vijim është paraqitur statusi i përparimit të të gjitha aktiviteteve dhe masave të parapara për vitin 2019 për këtë objektiv specifik, dhe krahasimi me grupin e treguesve.

1.1.2. Vendosja e rregullave dhe standardeve për konsultime publike në nivelin lokal është aktiviteti i cili është paraparë që të përgatitet dhe zbatohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me ZQM/ZKM-në dhe IKAP-in.
Rezultati i pritur është:

- Standardet dhe rregullat për konsultimet me publikun janë miratuar dhe zbatohen.

Përshkrimi i arritjes: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka përgatitur dhe miratuar Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 mbi standardet minimale për konsultimet publike në komuna. Dokumenti, po ashtu, synon që të promovojë dhe sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara me autoritetet lokale në nivelin lokal të bërjes së politikave dhe procesin e vendimmarrjes, për të promovuar transparencën komunale, si dhe për të ndikuar në zhvillimin e politikave të qëndrueshme të interesit të përgjithshëm[13]. Udhëzimi Administrativ i ka përcaktuar rregullat, parimet, format, procedurat dhe standardet minimale për konsultime publike në komuna gjatë hartimit të politikave dhe akteve nënligjore komunale, dhe këto dispozita duhet të zbatohen nga të gjitha organet përgjegjëse komunale, për të siguruar zbatimin efektiv të procesit të konsultimeve publike.
Gjatë vitit 2019, komuna janë duke i emëruar koordinatorët për konsultime publike, dhe ky është një prej hapave më të rëndësishëm në kursin e zbatimit të Rregullores dhe zbatimit të standardeve dhe rregullave për konsultime publike në nivel lokal.
Statusi i përparimit: **Zbatuar.**
Hapat e mëtejmë: Në vitin 2020 pritet zbatimi praktik i Udhëzimit Administrativ nga të gjitha komunat.
Buxheti total i planifikuar: 13.000 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 2000 EURO:

1.1.3. Ofrimi i një Programi Trajnues për Institucionet Qeveritare qendrore dhe lokale mbi Metodat e Përfshirjes së OSHC-ve në Politikë Bërje, është një grup aktivitetesh të planifikuara që të zbatohen nga ZQM/ZKM-ja në bashkëpunim me MAPL-në dhe IKAP-in ne vitet 2019 dhe 2020.
Rezultatet e pritura janë:

- Programi trajnues për institucionet qeveritare mbi metodat e përfshirjes së OSHC-ve në politikë bërje është finalizuar dhe shpërndarë
- Të ofrohen 9 seanca trajnuese për ministritë dhe komunat e përzgjedhura.

[13] Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale për Konsultime Publike në Komuna, është nënshkruar nga Ministri i MAPL-së në dhjetor të vitit 2018

Përshkrimi i arritjes: Koncepti i metodologjisë së programit trajnues dhe thirrja për trajnimet për zbatimin e standardeve të konsultimeve publike për të përfshirë OSHC-të në bërjen e politikave u finalizua në vitin 2019 nga ZQM-ja në bashkëpunim me Projektin e AT të financuar nga BE-ja. Krahas kësaj, janë përgatitur materialet për seancat trajnuese shtesë në kuadër të ministrive. Qëllimi i këtij programi është që të krijojë një grup prej 15 trajnerëve profesional në kuadër të administratës Qeveritare të cilët do të japin rregullisht trajnime për konsultimet publike në Republikën e Kosovës. Këta 15 shërbyes civil të trajnuar do të vazhdojnë të kalojnë njohuritë e tyre tek shërbyesit e tjerë civil të cilët punojnë në nivelin kombëtar dhe atë lokal. Trajnimet dhe i tërë procesi i të mësuarit do të zbatohet në vitin 2020.
Statusi i përparimit: **Në zbatim e sipër.**
Aktiviteti është planifikuar që të zbatohet në vitet 2019 dhe 2020. Aktivitetet fillestare dhe përgatitore kanë filluar, dhe pritet që të vazhdojnë të zbatohen në vitin 2020.
Hapat e mëtejmë: Në fillim të vitit 2020 do të zhvillohet trajnimi i trajnerëve. programi i trajnimit do të përfshijë një kombinim të trajnimeve teknike për konsultime publike, seancat për shkathtësitë fillestare dhe teknikat trajnuese të pjesëmarrjes aktive. Në fund të procesit, pritet që trajnerët të jenë në gjendje që të zhvillojnë trajnime të tyre ekuivalente për konsultimet publike duke e përdorur programin dhe materialet e dizajnuara nga ata apo të ofruara nga Projekti.
Në vitin 2020, pritet që të zhvillohet seanca trajnuese për ministritë dhe komunat.
Buxheti total i planifikuar: 12.000 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 6,000 EURO:

1.1.4. Avancimi dhe rritja e përdorimit të platformës online për konsultime publike **është paraparë që të zbatohet nga ZQM/ZKM-ja** në bashkëpunim me MAP-in dhe IKAP-in në vitin 2019.

Rezultatet e pritura janë:

- Platforma online e përmirësuar;
- Udhëzuesi në internet është zhvilluar dhe përdoret nga institucionet.

Përshkrimi i arritjes: Ka nisur puna fillestare për përditësimin e platformës online me qëllim të sigurimit që komunat të shfrytëzojnë platformën për zhvillimin e konsultimeve në nivel lokal. ZQM/ZKM-ja me mbështetjen e Projektit të AT të financuar nga BE-ja e ka përmirësuar dizajnin e Platformës Online për konsultime publike.
Në vitin 2019, përmirësimi i platformës është bërë në dy drejtime: së pari, përmirësimi i pengesave teknike të hasura nga institucionet dhe abonentët; dhe së dyti, zgjerimi i platformës me elemente të reja të cilat nuk kanë ekzistuar më parë. Për shkak të sistemit të prezantuar për konsultime publike në nivel lokal, në vitin 2019, platformës i janë shtuar module të reja për secilën komunë. Po ashtu, është ndërtuar një sistem për gjenerimin e statistikave për nivelin lokal.
Në fund të vitit 2019, platforma online për konsultime publike është përmirësuar dhe është tërësisht funksionale.

Janë përgatitur dy udhëzues për shfrytëzimin e platformës online për konsultime publike.

Statusi i përparimit: **Zbatuar.**
Hapat e mëtejmë: Në vitin 2020. Pritet mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i platformës online, si dhe promovimi i udhëzuesve për të gjitha institucionet relevante dhe shërbyesve civil në nivel kombëtar dhe lokal.
Buxheti total i planifikuar: 11.500 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 5,000 EURO:

1.1.5. Organizimi i trajnimeve në punë për Ministritë e përzgjedhura për përgatitjen e raporteve mbi rezultatet për konsultime publike është aktiviteti i planifikuar për vitin 2019, nën përgjegjësinë e ZQM/ZKM-së, MAPL-së dhe IKAP-it.
Rezultati i pritur është:

- Janë organizuar trajnime në punë për shtatë (7) ministri për përgatitjen e raporteve mbi rezultatet për konsultime publike.

Përshkrimi i arritjes: Gjatë vitit 2019, ministrive iu është ofruar mbështetje e vazhdueshme nga Zyra për Qeverisje të Mirë përmes informacionit ditor, përgjigjeve dhe qartësimeve sipas kërkesave të ministrive. Më mbështetje të Projektit të Komisionit Evropian, trajnime në punë i janë ofruar Ministrisë së Agrikulturës, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Seanca trajnuese në punë për këtë ministri është ofruar më 26 nëntor 2019, dhe u vijua nga 13 pjesëmarrje nga menaxhmenti dhe stafi i ministrisë.
Ministrive iu është ofruar mbështetje në mbledhjen e të dhënave dhe përgatitjen e raportit vjetor për konsultime publike për vitin 2019. Trajnim është zhvilluar me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përderisa mbështetje është ofruar edhe për Ministrinë e Drejtësisë. Sidoqoftë, nevoja për rritjen e bashkëpunimit dhe mbështetjes për ministritë në ndërtimin e kapaciteteve për procesin e konsultimeve publike vazhdon të jetë i lartë.
Statusi i përparimit: **Në zbatim e sipër.**
Hapat e mëtejmë: Në vitin 2020, pritet që të zhvillohen pjesa tjetër e trajnimeve të planifikuara.
Buxheti total i planifikuar: 5.000 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 2,000 EURO

1.1.6. Organizimi i seancave trajnuese për shfrytëzimin efektiv të Platformës Online është aktivitet i cili duhet të zbatohet në vitet 2019 dhe 2020 nga ZQM/ZKM-ja dhe Projekti i AT-së.
Rezultati i pritur është:

- 5 Seanca trajnuese me Ministritë dhe Komunat

Përshkrimi i arritjes:
Statusi i përparimit: **Në zbatim e sipër.**
Hapat e mëtejmë: Në vitin 2020, pritet që të zhvillohen trajnimet praktike.
Buxheti total i planifikuar: 5.000 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 3,000 EURO

1.1.7. Organizimi i takimeve koordinuese për Ministritë dhe Zyrat e ZKM-së, është paraparë që të organizohet dhe zbatohet nga ZQM/ZKM-ja në bashkëpunim me MAPL-në në vitin 2019.
Rezultatet e pritura janë:

- 6 takime të organizuara

Përshkrimi i arritjes: Ky është një proces në vazhdim e sipër në të cilin ZQM/ZKM-ja e ka rolin kryesor. Konsultimet e rregullta dhe aktivitetet koordinuese janë duke u praktikuar vazhdimisht. Janë organizuar tri takime koordinuese të ministrive dhe ZQM/ZKM-së.
Statusi i përparimit: **Në zbatim e sipër.**
Hapat e mëtejmë: Në vitet 2020 dhe 2021 pritet që të vazhdohet me koordinimin në mes të ZQM-së dhe institucioneve të tjera shtetërore në lidhje me zbatimin më të mirë të Rregullores 05/2016 mbi standardet minimale për konsultime me publikun dhe Strategjisë për Rregullore më të Mirë 2.0.
Buxheti total i planifikuar: Nuk ka buxhet të planifikuar. Vetëm shpenzime administrative.

Buxheti i shpenzuar në vitin 2019: N/A

1.1.9. Publikimi i praktikave më të mira të konsultimeve me institucionet qendrore dhe komunat, është aktivitet në të cilin duhet të përfshihen të gjitha ministritë dhe komunat. ZQM/ZKM-ja dhe MAPL-ja duhet të koordinojnë procesin e entiteteve.
Rezultatet e pritura janë:

- Praktikat më të mira të mbledhura, të publikuara dhe promovuara në institucionet qendrore dhe lokale.

Përshkrimi i arritjes: Aktivitetet fillestare kanë filluar në vitin 2019. Mbledhja e të dhënave dhe rasteve të praktikave më të mira janë në vazhdim e sipër. Tërësia e shembujve pozitiv dhe praktikave më të mira do të prezantohen në raportin vjetor për konsultime publike për vitin 2019.
Statusi i përparimit: **Në zbatim e sipër.**
Hapat e mëtejmë: Studimet e rasteve të praktikave më të mira të konsultimeve publike do të prezantohen në raportin vjetor për konsultime publike për vitin 2019.
Buxheti total i planifikuar: 3.000 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 1.000

1.2.1. Zhvillimi i një strategjie për komunikim me publikun mbi platformën Online dhe standardet e konsultimeve publike, është planifikuar që të zbatohet nga ZQM/ZKM-ja me mbështetjen e Projektit të AT-së.
Rezultatet e pritura janë:

- Strategjia për komunikim është zhvilluar, po diskutohet me anëtaret e Këshillit për bashkëpunim të qeverisë em shoqërinë civile.

Përshkrimi i arritjes: Strategjia për komunikim është përgatitur në vitin 2019.
Statusi i përparimit: **Zbatuar.**
Hapat e mëtejmë: Strategjia për komunikim do të promovohet nga ZQM/ZKM-ja me mbështetjen e Projektit të AT-së. Do të ndërmerren aktivitete për promovimin dhe operacionalizimin e plotë.
Buxheti total i planifikuar: 3.000 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 1,000

1.2.2. Zhvillimi i një fushate vetëdijesuese mbi standardet për konsultime publike, është planifikuar që të zbatohet nga ZQM/ZKM-ja.
Rezultatet e pritura janë:

- Udhëzuesi për përdorimin e platformës online për konsultime me publikun nga OSHC-të dhe qytetarët është zhvilluar dhe është në shfrytëzim.

Përshkrimi i arritjes: Aktivitetet përgatitore filluan në fund të vitit 2019. Janë përgatitur dy video me porosi motivuese për qytetarët se pse duhet të bëhen pjesë e procesit të konsultimeve publike për bërjen e politikave, si dhe udhëzime të qarta për qytetarët dhe OSHC-të se si të përdoret platforma online. Produksioni final do të jetë gati gjatë çerekut të parë të vitit 2020.
Statusi i përparimit: **Në zbatim e sipër.**
Hapat e mëtejmë: Prezantimi dhe transmetimi i videove në kanalet kombëtare televizive, si dhe në portalet e tjera dhe mediat sociale.
Buxheti total i planifikuar: 1.500 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 0 EURO

2.Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financim në zhvillimin e qëndrueshëm të programeve dhe projekteve të OSHC-ve me interes publik

Krahas vazhdimit të zbatimit të një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin publik të programeve të OSHC-ve, janë paraparë tri objektiva që janë relevante për qëndrueshmërinë e shoqërisë civile. Ky objektiv strategjik është dizajnuar mirë dhe përbëhet nga mbështetja e drejtpërdrejt financiare përmes financimit publik, dhe pastaj nga mbështetja indirekte me qëllim të përmirësimit të legjislacionit dhe praktikave individuale dhe filantropisë së korporatave, si dhe prezantimin e rregulloreve më të mira për përdorimin pronave në pronësi publike për qëllime të OSHC-ve. I tërë cikli i ndërhyrjes duhet të mbyllet me krijimin e një sistemi për bashkëfinancimin e projekteve të BE-së të cilat zbatohen nga OSHC-të, një praktikë që është prezantuar në shtetet e tjera në rajon.

Objektivi i parë strategjik (i përgjithshëm): Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financimin e programeve dhe projekteve të OSHC-ve me interes për publikun i ka katër objektiva specifike:

#	Objektivi i Përgjithshëm	Objektivi Specifik	
2	Përmirësimi i kornizës institucionale dhe ligjore për financimin e programeve dhe projekteve të OSHC-ve me interes për publikun	2.1	Forcimi i kapaciteteve të Ministrive dhe Komunave për zbatimin e standardeve të financimit publik të OSHC-ve
		2.2	Përmirësimi i kornizës ligjore dhe institucionale për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave
		2.3	Rregullimi i ndarjes së pronës në pronësi publike për shfrytëzim nga OSHC-të
		2.4	Krijimi i një sistemi për bashkëfinancim të projekteve të OSHC-ve të financuara nga BE-ja

Për Objektivin Specifik 2.1. është paraparë një rezultat:

Rezultati i Parë: Kapaciteti i shërbyesve civil për zbatimin e kritereve, standardeve dhe procedurave për financimin publik të OSHC-ve është përmirësuar.

Treguesi i Parë: Numri i shërbyesve civil të trajnuar për standardet e financimit publik të OSHC-ve.

- Synimi i përkohshëm për këtë tregues është 150 shërbyes civil të trajnuar deri në fund të vitit 2020. Aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve kanë filluar në vitin 2018. ZQM/ZKM-ja me mbështetjen e Projekti të AT-së të BE-së ka organizuar një sërë trajnimesh për ministritë dhe komunat. Në vitin 2019, fokusi ishte në nivelin lokal, ku janë trajnuar gjithsejtë 65 shërbyes civil nga katër komuna. Duke qenë se vlera bazë tashmë ishte 70 shërbyes civil të trajnuar, **trendi i rritjes së numrit është pozitiv, dhe e ka arritur nivelin e 135 shërbyesve tashmë të trajnuar**. Pritet që deri në përfundimin e periudhës së përkohshme (2020) synimi i planifikuar të arrihet në tërësi.

Për Objektivin Specifik 2.2. janë paraparë dy rezultate:

Rezultati i Parë: Krijimi i një kornize ligjore gjithëpërfshirëse për filantropinë individuale dhe të korporatave.

Treguesi i Parë: Aktet e nevojshme ligjore për rregullimin e filantropisë individuale dhe të korporatave të ndryshuara ose të miratuara.

- Synimi i përkohshëm është 75%. Çështja e përcaktimit të rregullores dhe ndryshimit të legjislacionit për filantropi individuale dhe të korporatave është diskutuar në vitin 2019 por, nuk janë ndërmarrë masa konkrete. Shumica e aktiviteteve për këtë objektiv specifik sipas Planit të Veprimit duhet të zbatohen gjatë viteve 2020 dhe 2021.

Rezultati i Dytë: Zyrtarët Tatimor janë trajnuar në pajtim me standardet ndërkombëtare.
Treguesi i Dytë: Numri i zyrtarëve të tatimit të trajnuar në praktikat për administrimin e përfitimeve në tatime për filantropi.

- Synimi i përkohshëm është 20 zyrtarë tatimor të trajnuar deri në fund të vitit 2020. Të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të zyrtarëve tatimor duhet të zbatohen pas miratimit të legjislacionit për individët dhe korporatat. Përparimi do të matet dhe prezantohet në raportin e dytë vjetor për zbatimin e Strategjisë për vitin 2020.

Rezultati i Tretë: Burimet e financimit të programeve të OSHC-ve janë më të larmishme.
Treguesi i tretë: % e rritjes së filantropisë individuale dhe të korporatave në baza vjetore.

- synimi i përkohshëm është rritje 10% e donacioneve individuale dhe të korporatave. Sipas Raportit të Dhuratave të Kosovës 2018 - Raportit Vjetor për Filantropinë Shtetërore, asociacionet dhe fondacionet vendore i kanë pranuar një të pestën e të gjitha donacioneve për vitin 2018 (19,8%). Në vazhdimësi të trendit nga viti 2017, qytetarët ishin donatorët më aktiv për OSHC-të. Si donator, sektori i korporatave vazhdoi të mbështeste OSHC-të në nivelin e njëjtë, gjë që mund të jetë një **tregues i një trendi të mëtejmë pozitiv dhe përfshirjes më aktive të kompanive në mbështetje dhe partneritet me OSHC-të**[14].

Për Objektivin Specifik 3: Rregullimi i ndarjes së pronës në pronësi publike për shfrytëzim nga OSHC-të dhe Objektivi Specifik 4: Krijimi i një sistemi për bashkëfinancim të projekteve të OSHC-ve të financuara nga BE-ja, asnjë aktivitet nuk është planifikuar për vitin 2019.

Prandaj, përparimi i zbatimit do të vlerësohet në raportin vjetor për vitin 2020.

Zbatimi i Aktiviteteve/Veprimeve

Në total, 20 veprime janë planifikuar në Planin e Veprimit, 7 prej të cilave janë për vitin 2019.
Në vijim është paraqitur statusi i përparimit të të gjitha aktiviteteve dhe masave të parapara për vitin 2019 për këtë objektiv specifik, dhe krahasimi me grupin e treguesve.

3.2.1. Zhvillimi i trajnimeve për zbatimin e Rregullores dhe për vlerësimin e propozimeve të projekteve dhe programeve të OSHC-ve për ministritë dhe komunat është një aktivitet i planifikuar për një periudhë trevjeçare (2019-2021). Institucionet përgjegjëse janë MF, ZQM/ZKM, MAPL me mbështetje të Projektit të AT-së. Rezultatet e pritura janë:

[14] Raporti i Dhuratave të Kosovës 2018 - Raportit Vjetor për Filantropinë Shtetërore, Catalyst Balkans

- Programi trajnues është zhvilluar dhe zbatimi i seancave trajnuese dhe punëtorive për vlerësimin e projekteve/programeve për OSHC-të në nivel qendror dhe lokal

Përshkrimi i arritjeve: Aktivitetet kanë filluar në vitin 2019. Është zhvilluar koncepti dhe metodologjia e programit për trajnimin e trajnerëve (TeT) mbi financimin publik në pajtim me shabllonet e Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Është lansuar thirrja për shprehjen e interesimit nga trajnuesit potencial për të marrë pjesë në programin për TeT. Qëllimi i programit është që të krijojë një grup prej së paku 15 trajnerëve profesional të cilët do të japin trajnime të rregullta për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OSHC-të në Republikën e Kosovës. Programi do të përfshijë një kombinim të shkathtësive teknike trajnuese, seancave për shkathtësitë fillestare dhe teknikat trajnuese për pjesëmarrje aktive si dhe komponentëve specifik për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OSHC-ve. Në fund të procesit, pritet që trajnerët të jenë në gjendje që të zhvillojnë trajnime të tyre ekuivalente për konsultimet publike, duke e përdorur programin dhe materialet e dizajnuara nga ata apo të ofruara nga Projekti.

Statusi i përparimit: **Në zbatim e sipër.**

Hapat e mëtejmë: Duke qenë se thirrja për aplikim u përgatit në fund të vitit 2019, pritet që programi trajnues të kryhet në fillim të vitit 2020. Programi do të përfshijë një kombinim të shkathtësive teknike trajnuese, seancave për shkathtësitë fillestare dhe teknikat trajnuese për pjesëmarrje aktive si dhe komponentëve specifik për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OSHC-ve.

Buxheti total i planifikuar: 12.000 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 4,000 EURO

3.2.2. Ofrimi i trajnimeve në punë si dhe mentorimit (duke e përfshirë rolin mbikëqyrës) për ministritë dhe komunat në përgatitjen dhe zbatimin e thirrjeve për financimin publik të projekteve dhe programeve të OJQ-ve,

është planifikuar që të zbatohet nga MF, ZQM/ZKM, MAPL me mbështetje të Projektit të AT-së, në një periudhë trevjeçare 2019, 2020 dhe 2021.

Rezultatet e pritura janë:

- Trajnime në vendin e punës dhe mentorim i dhënë për së paku 9 ministri dhe 15 komuna

Përshkrimi i arritjeve: Janë organizuar seanca trajnuese në punë mbi standardet e financimit publik për komunat e Mitrovicës së Jugut, Dragashit, Pejës, Prishtinës dhe Prizrenit. Shërbyesit Civil nga administrata komunale të cilët janë përgjegjës për financimin publik për OSHC-të (duke i përfshirë anëtarët e komisioneve vlerësuese, komisioneve të ankesave, etj.) e kanë vijuar trajnimin.

Në total, 65 pjesëmarrës i kanë vijuar që të katër trajnimet në punë.

Komuna	Data	Numri i pjesëmarrësve
Mitrovicë	3 korrik	10
Dragash	14 gusht	14
Pejë	11 shtator	21
Prishtinë	24 tetor	20
Prizren		
	Totali	65

Statusi i përparimit: **Zbatuar.**

Hapat e mëtejmë: Pjesa e mbetur e 10 trajnimeve në nivel lokal dhe nëntë në nivel qendror do të zhvillohen gjatë viteve 2020 dhe 2021.
Buxheti total i planifikuar: 5000 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 2,000 EURO

3.2.3. Organizimi i takimeve bashkërenduese të ZKM-së, ministrive dhe komunave për planifikimin e përbashkët dhe raportimin mbi financimin publik të OSHC-ve është aktivitet i planifikuar që të zbatohet nga ZQM/ZKM, MF, MAPL me mbështetjen e Projektit të AT-së.

Rezultatet e pritura janë:

- Së paku 5 takime koordinuese janë organizuar.

Përshkrimi i arritjeve: Përgjatë vitit 2019 janë organizuar disa takime koordinuese. Është zhvilluar edhe komunikim i rregullt online posaçërisht për qëllimet e përgatitjes së raportit vjetor, si dhe për organizimin e të gjitha aktiviteteve për mësim dhe trajnime në punë.
Statusi i përparimit: **Zbatuar.**
Hapat e mëtejmë: Vazhdimi i koordinimit, të mbahen takime koordinuese të paktën dy herë në vit.
Buxheti total i planifikuar: Vetëm shpenzime administrative
Buxheti i shpenzuar në vitin 2019: N/A

3.2.4. Publikimi i raporteve vjetore për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë, është aktivitet i planifikuar për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nën përgjegjësinë kryesore të ZQM/ZKM, MF, MAPL dhe Projektit të AT-së.
Rezultatet e pritura janë:

- Raportet vjetore të publikuara në kohë dhe në pajtim me kushtet e Rregullores.

Përshkrimi i arritjeve: Raporti Vjetor për financimin publik të OJQ-ve për vitin paraprak (2018) është finalizuar dhe më 21 qershor 2019 iu prezantua publikut të gjerë në një aktivitet ku morën pjesë zyrtarë të lartë qeveritar dhe të BE-së. Raporti u bazua në analizimin e të dhënave gjithëpërfshirëse të mbledhura nga ministritë dhe komunat dhe atij i është kushtuar interesim domethënës nga mediet. Ai përmban një analizë të thellë për fondet që iu dhanë OSHC-ve në nivel kombëtar dhe lokal, të ndara sipas: institucioneve, komunave, organizatave pranuese, qëllimin e mbështetjes, etj. Ai, po ashtu, ofron informacion për zbatimin e standardeve minimale për konsultime publike në shpalljet dhe raportimet për thirrjet publike. Siç është cekur në Raport, nga të dhënat e mbledhura nga Organizatat Buxhetore, ueb faqet e Organizatave Buxhetore dhe puna e kryer drejtpërdrejt nga ZQM-ja, për ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore, ka përparim të dukshëm në zbatimin e rregullores për financimin publik të organizatave të shoqërisë civile.

Statusi i përparimit: **Zbatuar.**
Hapat e mëtejmë: Pritet që deri në fund të marsit 2020 të publikohet dhe prezantohet Raporti Vjetor për Financimin Publik për OSHC-të për vitin 2019.
Buxheti total i planifikuar: 3.000 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 1,000

3.2.5. Përmirësimi i bazës qendrore të të dhënave online për financimin publik të OSHC-ve në Kosovë ojqfinancime.rks-gov.net zbatohet nga ZQM/ZKM dhe Projekti i TA-së.
Rezultatet e pritura janë:

- Baza qendrore e të dhënave për financimin publik të OSHC-ve është zhvilluar dhe është tërësisht funksionale

Përshkrimi i arritjeve: ZQM-ja është mbështetur nga Projekti i AT-së në përgatitjen e këtij aktiviteti. ZQM në bashkëpunim me ekspertë të ekipit të AT-së, i ka përgatitur përmirësimet e nevojshme për bazën e të dhënave mbi financimin publik të OJQ-ve dhe ka futur funksione të reja.
Statusi i përparimit: **Zbatuar.**
Hapat e mëtejmë: Platforma me të gjitha funksionet e reja tani më është gati gjatë dhe u lansu me 03 mars 2020. Po ashtu, ekziston nevoja për të siguruar burimet njerëzore përkatëse në Qeveri me qëllim që të sigurohet mirëmbajtja e Platformës pas përfundimit të projektit të AT-së të financuar nga BE-ja.
Buxheti total i planifikuar: 2.500 EURO; Planifikuar për vitin 2019: 2,500 EURO

3.2.6. Rritja e rolit mbikëqyrës të MF-së në zbatimin e Rregullores është përgjegjësi e MF, ZQM/ZKM dhe Projektit të AT-së.
Rezultatet e pritura janë:

- MF (Dep. i Buxhetit) u ka dërguar letër qarkore ministrive dhe komunave mbi zbatimin e Rregullores

Përshkrimi i arritjeve: Nuk ka informacion
Statusi i përparimit: **Në zbatim e sipër**
Hapat e mëtejmë:
Buxheti total i planifikuar: Kostot administrative
Buxheti i shpenzuar në vitin 2019: N/A

3.2.7. Krijimi dhe fuqizimi i mekanizmave institucional për zhvillimin e filantropisë individuale dhe të korporatave është planifikuar që të zbatohet në bashkëpunim me ATK, FIQ dhe Projektin e AT-së.
Rezultatet e pritura janë:

- Përkufizimi i përgjegjësive institucionale për monitorimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore dhe të politikave për filantropinë;
- Trajnimi i personelit përkatës nga institucionet përgjegjëse për politikat e filantropisë.

Përshkrimi i arritjeve: Ndonëse, disa nisma fillestare janë ndërmarrë në nivelin e diskutimeve në vitin 2019, nuk ka ndryshime në legjislacion në lidhje me filantropinë individuale dhe atë të korporatave. Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale parasheh zbritje në tatim deri në 10% të të hyrave të tatueshme për donacionet e korporatave dhe individëve. Këto përfitime tatimore ofrohen vetëm për një grup të përzgjedhur të aktiviteteve në dobi të publikut, të cilat janë në numër të ulët se lista e aktiviteteve në dobi të publikut në ligjin themelor për OJQ-të. Si rezultat, Statusi i Dobisë për Publikun, nuk luan ndonjë rol në fitimin e përfitimeve të tilla. Duke e pasur parasysh këtë situatë, dhe në pajtim me Planin e Veprimit, kësaj çështje do t'i kushtohet vëmendje në vitin 2020.
Statusi i përparimit: **Në zbatim e sipër.**
Hapat e mëtejmë: Të gjitha aktivitetet e planifikuara do të realizohen në vitin 2020 dhe 2021.
Buxheti total i planifikuar:
Buxheti i shpenzuar në vitin 2019: N/A

3. Zhvillimi i praktikave dhe procedurave për kontraktimin e OSHC-ve në ofrimin e shërbimeve publike

Kontraktimi i OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike është një çështje tejet e rëndësishme në lidhje me qëndrueshmërinë e shoqërisë civile por, në të njëjtën kohë është e rëndësishme për shërbime më cilësore për njerëzit në nevojë.
Në Kosovë, kjo praktikë është krijuar kryesisht në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale por, prapë siç edhe është theksuar në këtë objektiv specifik, nevojiten përmirësime në legjislacion që duhet t'i rregullojnë standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve, si dhe për ngritjen e vetëdijes së institucioneve për modelet më të mira për kontraktimin e OSHC-ve.

Objektivi i tretë strategjik (i përgjithshëm): Zhvillimi i praktikave dhe procedurave transparente për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike i ka katër objektiva specifike:

#	Objektivi i Përgjithshëm	Objektivi Specifik	
3	Zhvillimi i praktikave dhe procedurave transparente për kontraktimin e OSHC-ve për ofrimin e shërbimeve publike	3,1	Përmirësimi i kornizës së përgjithshme ligjore dhe institucionale për rregullimin e aktiviteteve ekonomike të OSHC-ve
		3,2	Përmirësimi i vetëdijes së institucioneve rreth modeleve që janë në dispozicion për kontraktimin e OSHC-ve
		3,3	Sigurimi i mbledhjes sistematike dhe qasja në të dhënat për OSHC-të si ofrues të shërbimeve për Ministritë dhe Komunat
		3,4	Përmirësimi i ligjeve që i rregullojnë standardet dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve publike nga OSHC-të

Për Objektivin Specifik 3.3. është paraparë një rezultat:

Rezultati i Parë: Të dhënat e OSHC-ve që ofrojnë shërbime është përfunduar dhe publikuar.
Treguesi i Parë: % e kompletit të të dhënave të plotësuar me informacionin për OSHC-të të cilat mund të ofrojnë shërbime publike.

- Nuk është planifikuar ndonjë synim i përkohshëm. Sidoqoftë, çështja e shërbimeve publike duhet të zhvillohet në të ardhmen. Aktualisht, vetëm Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale njihet si institucion që i mbështet OSHC-të në ofrimin e shërbimeve. Pika e nisjes, krahas nevojës për përmirësimin e mëtejmë të legjislacionit, duhet të jetë krijimi i bazës së të dhënave për OSHC-të të cilat janë ofruese të shërbimeve.

Për Objektivin Specifik 3.1. Objektivin Specifik 3.2 dhe Objektivin Specifik 3.4. nuk është planifikuar asnjë aktivitet për vitin 2019. Prandaj, përparimi i zbatimit do të vlerësohet në raportin vjetor për vitin 2020.

Zbatimi i Aktiviteteve/Veprimeve

Në total, 9 veprime janë planifikuar në Planin e Veprimit, 1 prej të cilave janë për vitin 2019. Në vijim është paraqitur statusi i përparimit të të gjitha aktiviteteve dhe masave të parapara për vitin 2019 për këtë objektiv specifik, dhe krahasimi me grupin e treguesve.

3.3.1. Krijimi i një baze të të dhënave me të gjithë informacionin e nevojshëm për OSHC-të të cilat ofrojnë shërbime publike dhe OSHC-të e mundshme të cilat mund të bëhen ofrues të shërbimeve publike Rezultatet e pritura janë:

- Dizajni i bazës së të dhënave është përfunduar
- Baza e të dhënave është lansuar
